

## **Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës**

### **1. Informacion Bazë**

- Viti i Themelimit: 2004
- Statusi Ligjor: Qendër/ Organizatë jo fitimprurëse
- Selia Qendrore: Durres, Shqiperi
- Faqja e Internetit: [www.csdcdurres.al](http://www.csdcdurres.al)
- Email kryesor i organizatës: [info@csdcdurres.com](mailto:info@csdcdurres.com)
- Telefoni kryesor i organizatës: +355682629527

### **2. Misioni**

Misioni i CSDC Durrës është të fuqizojë qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për të promovuar qeverisjen e mirë, pjesëmarrjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar. Ne mbështesim transparencën, barazinë dhe përfshirjen sociale si vlera themelore të veprimit tonë.

### **3. Vizioni (Opsionale)**

Vizioni i CSDC Durrës është një shoqëri demokratike, gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, ku qytetarët janë të informuar, aktivë dhe të angazhuar në mënyrë të barabartë në formësimin e politikave publike dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

### **4. Fushat Kryesore të Fokusit**

- Qeverisja e Mirë dhe Pjesëmarrja Qytetare
- Zhvillimi i Rinisë dhe Edukimi Qytetar
- Advokimi për Politika Lokale dhe Transparencë Publike
- Fuqizimi i Shoqërisë Civile dhe Mbështetja për OShC-të
- Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndërgjegjësimi për Çështjet Klimatike

### **5. Aktivitetet/Programet Kryesore**

- Projekti : Monitorimi i Zgjedhjeve në Bashkinë Durrës

Qëllimi i projektit është të rrisë transparencën dhe besimin e qytetarëve në proceset zgjedhore përmes vëzhgimit aktiv të zgjedhjeve parlamentare dhe vendore. Janë angazhuar dhjetëra vëzhgues lokalë dhe janë hartuar raporte analitike me rekomandime për përmirësime sistematike.

- Projekti : Forcimi i Shoqërisë Civile për Transparencë Buxhetore

Në kuadër të këtij projekti janë angazhuar OShC vendore dhe qytetarë në monitorimin e buxhetit të Bashkisë Durrës, veçanërisht në njësitë administrative më të margjinalizuara. Janë zhvilluar forume publike dhe janë paraqitur kërkesa për qeverisje më të hapur.

- Projekti: Digital Inclusion Initiative (DII)

Ky projekt synon të përmirësojë përfshirjen digjitale të grupeve të margjinalizuara, veçanërisht të rinjve dhe grave në zonat urbane dhe rurale. Në kuadër të iniciativës janë ofruar trajnime praktike mbi aftësitë digjitale bazë dhe të avancuara, janë ngritur hapësira të pajisura me teknologji (digital corners) dhe është promovuar përdorimi i shërbimeve online për arsim, punësim dhe pjesëmarrje qytetare. Përfituesit kryesorë përfshijnë të rinjtë në pamundësi ekonomike, gratë papunë dhe komunitetet e përjashtuara socialisht, të cilëve u është ofruar qasje dhe mbështetje

## **Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës**

për të kapërcyer hendekun digjital dhe për të rritur mundësitë e tyre për integrim social dhe ekonomik.

### **6. Shtrirja Gjeografike**

CSDC Durrës operon kryesisht në Bashkinë Durrës dhe zonat përreth, përfshirë njësitë administrative. Organizata ka gjithashtu përvojë në zbatimin e projekteve në qytete të tjera si Kavajë, Krujë, Tiranë dhe Elbasan, në bashkëpunim me rrjete kombëtare dhe partnere ndërkombëtare. Shtrirja gjeografike është zgjeruar në përputhje me natyrën e projekteve, duke mbuluar fusha të tilla si monitorimi zgjedhor, përfshirja qytetare, dhe përfshirja digjitale në komunitete urbane dhe rurale.

### **7. Udhëheqja**

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Mirjam Reçi

Bordi i Drejtuesve: Redi Myshketa, Arlinda Baçi, Edvana Tiri

### **8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)**

CSDC Durrës ka ndërtuar partneritete të qëndrueshme me institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me organizata të shoqërisë civile. Ndër partnerët dhe donatorët kryesorë përfshihen: Komisioni European, përmes programeve Erasmus+ dhe European Solidarity Corps, UNDP Albania, si dhe organizata kombëtare si Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), GADC, AWEN etj. Gjithashtu, CSDC ka bashkëpunuar me Zyrën e Bashkimit European në Shqipëri, Ambasadën e Suedisë në nisma që lidhen me përfshirjen rinore, qeverisjen e mirë, edukimin qytetar, dhe përfshirjen sociale. Rrjeti i bashkëpunimeve është zgjeruar gjithashtu përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare dhe trajnime evropiane për fuqizimin e kapaciteteve organizative dhe vullnetarizmit.

### **9. Ndikimi (Opsionale)**

- Mbi 500 të rinj janë përfshirë në trajnimet dhe nismat për edukim qytetar, integritet dhe luftë kundër korrupsionit në arsim.
- Mbi 120 vëzhgues zgjedhorë lokalë janë trajnuar dhe angazhuar në proceset e monitorimit të zgjedhjeve që nga viti 2013.
- Janë zhvilluar mbi 20 forume publike dhe debate mes qytetarëve dhe kandidatëve politikë në kuadër të platformës “Përballja e Ofertave Politike (POP)”.
- Më shumë se 30 organizata lokale janë mbështetur me asistencë teknike dhe trajnime për rritjen e kapaciteteve organizative dhe përfshirjen në advokim dhe transparencë buxhetore.
- CSDC ka marrë Etiketën e Cilësisë nga European Solidarity Corps, duke certifikuar organizatën për angazhimin e të rinjve në vullnetarizëm deri në fund të vitit 2027.

### **10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)**